



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[eëë.avokatipopullit.gov.al](http://eëë.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300756/16

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandohet sigurimi në mënyrë të plotë i trajtimit shëndetësor për të bugosurit dhe kushte të përshtatshëm për të dënuarit me masë mjekësore "Mjekim i detyruar" në menyrë parandalimin e rasteve të vetëvrajse nëpër IEVP.

**Drejtuar:** DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

**TIRANË**

**INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

**SHËNKOLL-LEZHË**

*Të nderuar,*

Në datën 07.09.2023, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shenkoll Lezhë, një i burgosur i ka dhënë fund jetës duke u vetëvarur në ambientet e burgut. Sipas raportimeve viktime ishte i burgosuri Qerim Hani, 38 vjeç, i cili kishte kryer veprën penale "dhunë në familje" dhe ndaj tij ishte caktuar masë mjekësore "mjekim i detyruar" në institucionin mjekësor të IEVP Shenkoll, Lezhë. Gjithashtu, në media u raportua se viktime vuante nga çrregullimi psikotik dhe merrte mjekim të detyruar<sup>1</sup>.

Me marrjen dijoni të këtij lajmi, Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe intervistimin e bashkëvuajtësve dhe të stafit të IEVP Shenkoll Lezhë, në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në këtë institucion.

<sup>1</sup><https://top-channel.tv/2023/09/07/vetevaret-i-burgosuri-ne-shenkoll-te-lezhes/>

Për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohej janë kryer veprimet hetimore si vijon: Marrja e shpjegimeve verbale nga Jurind Gjergji, nëndrejtor i I EVP Lezhë; shpjegimeve verbale nga Ndue Prenga, Shefi i Sektorit Shëndetësor në I EVP Lezhë; shpjegimeve verbale nga Laurent Kërçi, mjeku që i ka dhënë ndihmën e parë të burgosurit të vetvarur; Këqyrja e kamerave të sigurisë: Këqyrja e vendit të ngjarjes; Administrimi i kartelës klinike, dosjes psiko-sociale të të burgosurit të vetvarur dhe të raportit të ngjarjes, administrimi i akt ekspertimit nr. 7565/8 prot, datë 07.11.2023, vendimi i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Mat, për rivlerësimin e masës mjekësore “Mjekim i detyruar” me nr. 3, datë 21.04.2022, si dhe administrimi i korospondencat me institucionet tjera përgjegjëse.

Sipas materialit të mbledhur rezulton se, i vetmi episod që mund të shërbente si tregues për personelin e I EVP Lezhë, është se burgosuri Qerim Hani shfaqte shenja të një rreziku për vetëvarje, ka qenë raport incidenti i datës 07.09.2023, kur punonjësi i policisë z. Florian Deda është informuar nga bashkëvuajtësit me masë mjekësore mjekim i detyruar se i burgosuri Qerim Hani po tenton të varë vetën në ambientet e dusheve në godinën nr. 5 kati 3, në orën 12:20 min me një lidhëse të provizuar prej tij. Ndërsa sipas deklaramit nëndrejtorit të I EVP Shenkoll Lezhë, z. Jurind Gjergji informon se në datën 07.09.2023, rreth orës 11:50, i burgosuri Qerim Gjeto Hani (38 vjeç), ka hyrë në dushet e përbashkëta të katit të tretë, Godina 5. Rreth orës 12:00, një i burgosur tjetër, i cili ka hyrë në mjedisin e dusheve, ka njoftuar punonjësin e policisë që shërbente në këtë sektor se një i burgosur tjetër po realizonte vetvarje. Punonjësi i policisë fillimisht ka prerë copën me të cilën është realizuar vetvarja dhe ka njoftuar menjëherë stafin mjekësor. Të burgosurit i është ndihma e parë mjekësore. Stafi mjekësor ka vlerësuar se ai duhet të dërgohet për ndihmë më të specializuar në Spitalin Rajonal Lezhë, ku është shoqëruar me autoambulacë me shenja jete, por atje ka ndërruar jetë.

Ndërsa, në deklaramin e e shefit të shërbimit shëndetësor Ndue Prenga, thuhet se pacienti Qerim Hani ka kryer veprën penale të “Dhunës në familje”. Ndaj tij është caktuar masa mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” dhe është i diagnostikuar me “çrregullim psikotik i pascifikuar”. Ky shtetas më parë mbahej në I EVP Krujë (Zahari) ku ka qëndruar 7 vite dhe në vitin 2021 është transferuar në I EVP Lezhë në sektorin e personave me probleme të shëndetit mendor. Gjatë qëndrimit në I EVP Lezhë nuk ka shfaqur sjellje që të bëjnë të dyshosh se ai mund të kryejë vetvrasje. Ai ka qenë bashkëpunues me stafin, ushqehet normalisht, merrte mjekimin rregullisht. Në datën 04.09.2023 (ditë e Hënë) ai ka patur takimin e parë pas 9 vitesh me familjarët, më konkretisht me vëllezërit. Ky takim mund të ketë ndikuar në gjendjen e tij psikologjike. Ndihma e parë këtij të burgosuri i është dhënë nga mjeku Laurent Kërçi dhe nga ndihmësmjeku Julian Sallaku.

Ndër të tjerat, në vijim të deklaramit të mjekut që ka dhënë ndihmën e parë Laurent Kërçi sqaron se pacienti është gjetur i shtrirë në dysheme me lak në fyt (mendohet se ka përdorur pjesë të prera cohe). Frymëmarrja ka qenë sipërfaqësore dhe ka bërë lëvizje spazmike. I është bërë prova me dritë, refleksi optik, si dhe i është matur pulsi. Janë ndier rrahje sporadike të arteria karrotide. Personi ka rezultuar me shenja jete. Në këto kushte i është bërë masazh kardiak dhe i është aplikuar adrenalinë. Në vijim është vendosur në barrele dhe është shoqëruar me autoambulancë në Spitalin Rajonal Lezhë.

Ky rast tregon se, një shqetësim psikologjik në dukje i parëndësishëm, të luhatje humorit apo gjendjes psikologjike të pacientit Qerim Hani me masë mjekësore” Mjekim i detyruar”, mund të shërbejë si informacion për personelin e burgut për të kuptuar se kemi të bëjmë

me një rrezik të shtuar të vetëvarjes. Punonjësit e policisë, që përbëjnë frontin e parë të parandalimit të vetëvarjes, duhet të informojnë për çdo episod, jo vetëm personelin shëndetësor, por edhe atë social, të cilët sa më parë duhet të marrin takim me të burgosurit që paraqet rrezik potencial. Gjithashtu, ekipet multidisiplinare që janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e këtyre pacienteve duhet të lihen detyra për personelin e sektorit policor që të vëzhgojnë të burgosurit gjatë veprimeve të tyre në ambientet që nuk monitorohen nga kamerat, siç janë ambientet e dusheve dhe tualeteve të përbashkëta.

Këqyrja e pamjet filmike të kameras së sigurisë, në kamera 173, Godina 5, kati 3, sektori 3, Kamera 1 (kamera e koridorit) Ora 11:50:30, i burgosuri Qerim Hani, i veshur me tuta dhe bluze me mëngë të shkurtra, me ngjyrë të bardhe me vija të zeza, hynë i qetë, me hap të ngadaltë në mjedisin e dusheve të përbashkëta. Ora 12:23, në mjedisin e dusheve të përbashkëta hyn një i burgosur tjetër, i cili del pas pak dhe komunikon me punonjësin e policisë. Ky i fundit hyn menjëherë në këtë mjedis. Ora 12:24 punonjësi i policisë del nga dushet për të njoftuar stafin mjekësor. Ora 12:25 në dushet hynë mjeku, ora 12:27, në koridor shfaqet një person me barrelë, ora 12:35, shtetasi vetvarur nxirret me barrelë nga dushet. Kamera 106 (oborri jashtë regjimit të brendshëm të IEVP Lezhë) Ora 12:37 autoambulanca bashkë me të burgosurin e vetëvarur del jashtë IEVP-së.

Pamjet filmike të kameras së sigurisë tregojnë se nga konstatimi i rastit të vetvarjes të pacientit Qerim Hani në ambientet e përbashkëta të dusheve deri në dhënies ndihmes mjekësore ka qenë e shpejtë për rreth 3 minuta dhe dërgimi i tij menjëherë me autoambulancë në Spitalin Rajonal Lezhë. Ndërsa nga ana tjetër sipas pamjeve filmike nga momenti i hyrjes në dushë deri në momentin e konstatimit ka qenë relativisht 33 minuta, kjo tregon se sektori policor ka dështuar në emisionin e saj për të garantuar dhe vëzhguar veprimet e këtyre pacienteve për sigurimin e jetës dhe shëndetit të personave me masë mjekësore mjekim i detyruar apo raste të tjera të personave të çregullimit të shëndetit mendor nëpër IEVP<sup>2</sup>.

Nga këqyrja e vendit të ngjarjes në mjedisin e dusheve është i përbërë nga tre hapësira: një hapësirë si paradhomë ky hyhet nga dera e koridorit të sektorit; dy hapësira, secila me nga katër bokse për të bërë dush, e ndarë nga paradhoma me murë dhe derë. Bokset ndahen nga njëra tjetra vetëm me murë në krahë dhe në pjesën ballore janë të hapura. Në çdo bokse në lartësinë mbi 1 m e 90 cm është vendosur ose një tub vrtikal i gjatë me harkim në fund ose një tub i shkurtër me kokë dushi për t'u larë. Shtetasi Qerim Hani e ka realizuar vetvarjen në boksin ku larja kryhet me tubin e gjatë vertikal.

Ne vlerësojmë se, instalimi i dusheve në këtë mënyrë ka përbërë shkak për vetëvrjen e pacientit Qerim Hani, me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Avokati i Popullit kërkon për heqjen e menjëhershme elementeve të tillë që përbën rrezik për kushtet e sigurisë, për jetën dhe shëndetin e të burgosurve. Në këto kushte, të gjenden mekanizmat që pajisjet hidrosanitare në këto ambiente, të vendosen në brendësi të murit duke mos lënë shkak nga të burgosurit për vetëdëmtim apo vetëvarje.

Vlen të theksojmë që në krye të herës se, në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara dhe të ratifikuara nga legjislativi shqiptar, përcaktohet qartë se, shtetasit për të cilët është

---

<sup>2</sup> Ligji nr. 80/2020 “Përr policinë e Burgjeveve”.

dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”, **nuk** duhet të jenë të akomoduar në IEVP në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por ata duhet të trajtohen në një Institucion të Posaçëm Mjekësor në varësi të MSHMS.

Nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandime të përsëritura për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor<sup>3</sup>, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit.<sup>4</sup> Por këto rekomandime nuk është zbatuar ende nga institucionet përgjegjëse.

Kapaciteti fizik i dy godinave në IEVP Shënkoll Lezhë, që janë akomoduar pacientet me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e tyre është 184 paciente, ndërsa në kohën e kryerës së vetëvrasjes së pacientit Qerim Hani ishin 428 pacientë.

Situatë mbipopullimi kishte ndikuar në përkeqësimin e kushteve të jetesës të të pacienteve me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, sidomos në dhomat e banimit ku ishin akomoduar nga 6 deri 10 veta. Kjo situatë e mbipopullimit, kishte cënuar parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit. Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në ambientet e këtij institucioni.

Personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes së tyre. Megjithatë, ashtu sikurse është përmendur në rekomandimet në vite të institucionit të Avokatit të Popullit, situata e mbipopullimit, mungesat në stafin mjekësor të specializuar si dhe në radhët e ekipit multidisiplinar e bënin të pamundur respektimin e këtij standardi të vendosur edhe nga institucionet kombetare e ndërkombëtare<sup>5</sup>, për këtë qëllim.

Gjatë hetimit administrativ, të këtij rasti, institucionit i Avokatit të Popullit mori takim me vëllain e pacientit me masë “Mjekësore mjekim i Detyruar”, z. Nerim Hani, i cili me anë të telefonit na informoi se me datë 04.09.2023, ditë e hënë kishte marrë takim me vëllain e tij Qerim Hani në ambientet e IEVP Shënkoll Lezhë. Ai na informoi se gjatë takimit që kishin zhvilluar më vëllain e tij nuk kishin konstatuar ndonjë shqetësim nga ana e tij për ndonjë veprim të tillë, i vetëm gjë që ka thënë është që të hiqet masa mjekësore Mjekim i detyruar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. Me premtimin që do të ndjekin këtë problematikë të ngritur nga i vëllai i tyre i burgosuri Qerim Hani me anë të një avokati të marrë nga vëllezërit e tij. Në këto rrethana janë larguar nga takimi me pretendimin që do të takoheshin përsëri në lidhje me pretendimin e ngritur nga ai.

---

<sup>3</sup>Referuar ligji nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ka përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

<sup>4</sup> Shih nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”. Ku thuhet se “Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

<sup>5</sup> CPT/Inf (92) 3 – part 2, parag. 56.

Në kuadër të hetimit administrativ, nga ana jonë i është kërkuar informacion dhe dokumentacion institucionit të Ekzekutimeve të Vendime Penale Leshë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Spitalit Rajonal Lezhë, Institutit Mjekësisë Ligjore Lezhë dhe Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Lezhë.

Istytucioni i Ekzekutimeve të Vendime Penale Lezhë na informon me shkresë nr. 10670 prot, datë 14.09.2023, për mungesa në organikë e IEVP Shënkoll Lezhë saktësisht: sektori policor gjithësej 201 punonjës, nga këto 9 punonjës në mungesë, stafi shëndetësor 22 punonjës nga të cilët në mungesë 1 mjek kardilog, 1 mjek të përgjithshëm dhe një mjek të përgjithshëm me kohë të pjesshëm.

institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj për trajtimin e këtyre personave, rezultojnë se, gjendja e kushteve materiale dhe akomoduese, si dhe, organika e stafit shëndetësor dhe atij policor, nuk i përgjigjet dinamikës në rritje të pacientëve me masë mjekësore në këtë IEVP. Struktura e re organike është e miratuar për një kapacitet prej 189 persona, ndërkohë që nuk i përgjigjet numrit prej 428 pacientë që ndodheshin në ditën e ngjarjes në këtë institucion.

Mungesa e stafit të sektorit policor dhe atij shëndetësor për të përgjigjur në kohë pacientëve me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, ka sjellë pasoja në kushtet e mbrotjes së shëndetit mendor, në sigurimin e kujdesjes shëndetësore dhe në politikën parandaluese për mbrotjen e shëndetit të këtyre pacientëve.

Në përgjigje të shkresës tonë, Spitali Rajonal Lezhë na informon me shkresë 903/1 prot, datë 13.09.2023, duke na vënë dispozicion kopje të kartelë me numër 16044 e datës 07.09.2023. Nga këqyrje e kartelës klenike të pacientit Qerim Hani, rezultojnë se me datë 07.09.2023, është paraqitur pacienti nga IEVP Shënkoll Lezhë, pa shëndja jete.

Instituti i Mjekësisë Ligjore me anë të shkresës me numër 7565/8 prot, datë 07.11.2023, na informon se në trupin e shtetasit Qerim Hani u konstatua brazdë strangulimi e pjerrët, në qafë, si dhe dy brazda poshtë saj, vetëm në pjesën përparme të saj, maviosje e fytyrës. Piketime hemoragjike në cipat e mushkrive, infiltrime hemoragjike në indet e buta dhe muskujt e qafës si dhe stazë e organeve në përgjegjësi. Për sa më sipër këto janë shkaktuar nga shtërgimi i lakut në qafë nëpërmjet peshës së trupit. Dy dermishjet me anën e majte poshtë brazdës janë dermishje hezitimi. Ndërkohë nuk u konstatuan dëmtime të jashtme trupore apo shenja të dhunës fizike. Gjithashtu informohemi se vdekja e shtetasit Qerim Hani ka ardhur nga asfiksia e mekanike si pasojë e shtrëngimit (shtypës) të qafës me lak nëpërmjet peshës së vet trupit.

Në përgjigje të shkresës tonë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë na informon se në bazë të materialeve të referuar me shkresën 1195 prot, datë 08.09.2023, të shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm në sistemin e burgjeve ka regjistruar procedimin penal 914/2023 për veprën penale, “shpërdorimin i detyrës” parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal. Nga veprimet e para hetimore dyshohet se, vetëvrasje ka ndodhur me litar, ndërsa nuk është administruar akoma akti i ekspertimit mjeko-ligjor.

Në përfundim të hetimit të kryer në IEVP Shënkoll Lezhë dhe nga administrimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në lidhje me ngjarjen e rëndë, ku si pasojë ka ndërruar

jetë pacienti, shtetasi Qerim Hani, si dhe informacioni i dhënë nga institucionet përgjegjëse në lidhje me rastin në fjalë, konstatojmë se:

- ✚ Nga këqyrja e kartelës shëndetësore, i burgosuri me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar” vuante nga probleme të çrregullimit psikiatrik. Lidhur me këtë problematikë konstatojmë se ekipet multidisiplinare ka dështuar në emisionin e tyre për të garantuar dhe vëzhguar veprimet e këtyre pacienteve me masë mjekësore “Mjekim të detyruar” nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.
- ✚ Në këqyrjen e vendit të ngjarjes në mjediset e dusheve dhe instalimi i dusheve në këtë mënyrë ka përbërë shkak për vetëvrijen e pacientit Qerim Hani, me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Stafit i IEVP-së duhet të vlerësonin që kushtet në këtë institucion duhet të jenë të tilla që mos përmbajnë indicie nga këto pacientë për vetëdëmtim apo vetëvarje.
- ✚ Mungesa në organikën e stafit mjekësor nuk garanton një shërbim shëndetësor cilësor për të burgosurit, në mënyrë që të garantojnë ruajtjen e shëndetit të personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se mungesa e mjekut kardiolog, mjeku laborant dhe mjeku me kohë të pjesëshëm ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit në IEVP Shënkoll Lezhë. Gjithashtu, struktura e re organike është miratuar për 189 persona, ndërkohë në ditën e ngjarjes ishin 428 pacientë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, duke mos ju përgjigju numërit kaq të lartë të këtyre personave.
- ✚ Konstatohet se nuk është garantuar akomodimi i të dënuarve dhe të burgosurve në mjediset të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë. Ku nuk plotësojnë kushtet minimale për trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitimin shëndetësor të tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar i kërkon në mënyrë të përsëritur Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Shëndetësisë plotësimin e stafit shëndetësorë, psiko-social sipas ligjit dhe akteve ligjore në fuqi, si dhe ofrimin e shërbimit psiko-social nga ana punonjësve të edukimit, duke ofruar asistencën e tyre çdo ditë me frekuencë 4 orë, nëpërmjet bisedave dhe aktiviteteve me këto pacientë me masë mjekësore “mjekim të detyruar”. Kjo do të krijonte një klimë të sigurt që ushqen besim reciprok, u krijon të dy palëve në komunikim të ndiejnë përgjegjësi, u ofron më shumë liri zgjedhjeje dhe si rezultat u mëson të kenë më shumë aftësi sociale. Gjatë gjithë kohës, nga ana e stafit të kujdesit social duhet të zhvillohen tema të ndryshme për të përballuar presionin e grupit, për të përvetësuar aftësitë dhe për t’u përshtatur me jetën e re sociale. Mungesa e stafit mjekësor në këtë institucion ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për shmangien e situatave të tilla, duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit mjekësor, pasi ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, për një mjedis sa më pak shtrëngues si dhe për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social të tyre.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor, në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin dhe heqjen e të gjithë elementëve që krijojnë premisa për vetëdëmtime për këta pacientë, si konkretisht zëvendësimin e dusheve dhe elementëve të tjerë për të parandaluar raste të tilla.
2. Analizimin me hollësi të rastit nga strukturat kompetente të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për punonjësit e Policisë së Burgjeve, të sektorit psiko-social dhe atij shëndetësor në I EVP Lezhë, në objekt të këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të ofrimit cilësor të shërbimit ndaj burgosurve me masw mjekwsore “Mjekim i Detyruar”, pwr tw kuptuar emocionet e tyre në sjelljet e pwr ditshme dhe pwr tw lwnw detyra për personelin e sektorit policor që të vëzhgojnë të burgosurit gjatë veprimeve të tij në ambientet që nuk monitorohen nga kamerat në kwtw institucion.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e stafit të sektorit shëndetësor për pacientët me masë mjekësore “Mjekim i Detyruar”, si dhe duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku qëndrojnë këta pacientw, higjienës vetjake të tyre dhe mjedisit që i rrethon. Keto persona kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012, “Për Shëndetin mendor”, i ndryshuar.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve higjiëno-sanitare, për të garantuar akomodimin kwto persona në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe rekomandimeve të CPT për këtë qëllim.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**